



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:045274
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05629715
KE.nr.2640/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit “Pandora A/S”, me seli në Danimarkë, Havneholmen 17-19, DK-1561, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit D.P.Z. “Luli-2”, me seli në Prizren, rruga “Sheshi i Shatërvanit”, nr.81, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Ostrozubi, avokat në Prizren, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, jashtë seancës, më datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit “Pandora A/S”, me numër KE.nr.2640/22 (2024:045274) e datës 02.11.2022, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, kundër të paditurit D.P.Z. “Luli-2”.
- II. SHFUQIZOHET masa e sigurimit e caktuar me Aktvendimin KE.nr.2640/22 të datës 28.04.2023, nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.
- III. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi Pandora A/S përmes të autorizuarit të tij me datë 02.11.2022, ka paraqitur padi me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë pranë Gjykatës Komerciale të

Kosovës – Departamentit për Çështje Ekonomike, kundër të paditurit D.P.Z. “Luli-2”, me propozimin për caktimin e masës së sigurisë të precizuar nga seanca dëgjimore e datës 20.04.2023, ka kërkuar nga gjykata që të caktohet masa e sigurimit me të cilën do t’i ndalohet kundërshtarit të sigurimit ekspozimi, shitja apo çfarëdo forme e tregtimit të produkteve të cilat mbajnë markën tregtare PANDORA 013262, 018214 dhe 018068 nën kërcënim të pasojave juridike si dhe të obligohet kundërshtari i sigurimit që në afat prej 7 ditësh t’i paraqes gjykatës faturat e blerjes së mallrave të cilat shkelin markat tregtare Pandora, ndërsa me padi i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të marrë aktgjykim me të cilin do të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe të konstatohet se i padituri ka shkelur markën tregtare Pandora me numër 013262, 018214 dhe 018068, të i ndalohet të paditurit që të përdorë, importoj, eksportoj, të hedhë në treg çdo produkt që përmban shenjë që është identike apo e ngjashme me markën tregtare 013262 të datës 03.09.2014, markën tregtare me numër 018214 të datës 17.12.2015 dhe markën tregtare 018068 të datës 13.02.2014, të lejohet shkatërrimi i mallrave që shkelin markën tregtare dhe të obligohet i padituri të bëj shkatërrimin e tyre me shpenzime të veta në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, si dhe të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit t’ia paguaj shumën sipas ekspertizës financiare me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me Aktvendimin KE.nr.2640/22 të datës 28.04.2023 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë me të cilën i është ndaluar kundërshtarit të sigurimit ekspozimi, shitja apo çfarëdo forme e tregtimit të produkteve të cilat mbajnë markën tregtare PANDORA 013262, 018214 dhe 018068 nën kërcënim të pasojave juridike.

I autorizuari i paditësit me datë 26.03.2024 ka dorëzuar pranë gjykatës parashtrësë për tërheqje të padisë pasi që masa e sigurisë e caktuar nga gjykata e ka arritur efektin e saj ashtu që e paditura nuk ka vazhduar të shes produkte të cilat shkelin markën tregtare PANDORA dhe paditësi nuk ka interes juridik lidhur me vazhdimin e procedurës së iniciuar, andaj gjykatës i ka propozuar që padinë ta konsideroj si të tërhequr.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka caktuar seancë përgatitore me datë 27.03.2024, në të cilën ka qenë i pranishëm i autorizuari i të paditurit dhe i njëjti duke vepruar

në pajtim me nenin 261 par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 309 par. 1 të LPK-së më të cilin përcaktohet se: “*Masa e sigurimit e caktuar me vendim të gjykatës mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit*”, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe shfuqizoi masën e sigurimit, pasi që ka konstatuar se kanë pushuar arsyet për të cilat është caktuar kjo masë siguroese.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së të autorizuarit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2640/22, datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.